



## PROGRAMI I LËNDËS 2023-2024

### Përkthim dhe Interpretim C-A

**Titullari /pedagogu i lëndës (për programet profesionale):** Prof. Dr. Daniela TAMO,  
Dr. Jonida PETRO

**Ngarkesa:** 6 kredite, 60 orë seminare

**Viti akademik, semestri kur zhvillohet:** 2023-2024, viti i II. semestri I

**Lloji i lëndës:** e detyrueshme

**Programi i studimit:** Master i Shkencave në Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik

**Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:** [daniela.tamo@unitir.edu.al](mailto:daniela.tamo@unitir.edu.al),  
[jonida.petro@unitir.edu.al](mailto:jonida.petro@unitir.edu.al)

**Kodi i Etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

### PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Lënda Përkthim/Interpretim C në A zhvillohet në semestrin e parë të vitit të dytë të Masterit Shkencor në Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik. Lënda përmban gjithsej 60 orë, tërësisht të realizuara në formën e seminareve.

Nëpërmjet kësaj lënde synohet që studentët të njihen më tej me koncepte teorike dhe praktike të përkthimit dhe interpretimit në kuadrin tanimë të studimeve të Komunikimit Ndërkulturor dhe Turistik. Temat janë konceptuar të jenë në vazhdimësi të njohurive të përvetësuara në ciklin „Bachelor“ dhe në përputhje me aftësitë e nivelin gjuhësor të studentëve në gjuhën „C“, aftësi të cilat do të shfrytëzohen dhe në funksion të profilit të studimeve master. Seminaret do të përfshijnë diskutime e detyra që studentët të kenë mundësi të vënë në jetë çështje teorike e praktike me ndihmesën e pedagogeve së lëndës në drejtim të aftësive përkthyes/interpretative. Kështu ata do të zhvillojnë aftësi të reja komunikuese, shkruese e trajtuese. Pedagogët do të krijojnë mjedis të përshtatshëm për të punuar në grupe ose edhe individualisht sipas rastit dhe temës..

### Objektivat e lëndës:

Ky kurs synon:

- të pajisë studentët me njohuri të mëtejshme kyçe për teorinë dhe praktikën e përkthimit/interpretimit në kuadrin e studimeve të komunikimit ndërkulturor, ku një pjesë njohurish të përgjithshme studentët përkatës pritet t'i kenë përvetësuar në ciklin "Bachelor";
- t'u japë njohuritë e mjaftueshme në mënyrë që studentët të jenë në gjendje të kuptojnë dhe perceptojnë mirë nga kulturat dhe gjuhët C - A temat e caktuara nga pedagogu i lëndës;
- të zhvillojë më tej aftësitë e studentëve në lidhje me shprehjen e mendimeve kritike, komenteve, parashtrimin të një çështjeje për diskutim në fushën e përkthimit;
- të zhvillojë më tej aftësitë e studentëve për të interpretuar nga gjuha C në gjuhën A.
- të pajisë studentët me njohuritë e duhura mbi teknikat e aftësitë e përdorura në interpretim;

- t'i aftësojë studentët në teknikat e mbajtjes së shënimeve; parashikimit, analizimit, përpunimit dhe riformulimit të mesazheve;
- të sigurojë një kalim gradual drejt profesionit të guidës turistike përmes marrjes së aftësive të interpretimit në jetën reale;
- të ofrojë udhëzime për kodin e etikës dhe sjelljen e interpretëve;
- të ndërtojë aftësitë e të folurit publik të studentëve;

**KONCEPTET THEMELORE:**

- Turizmi dhe përkthimi
- Kultura dhe përkthimi
- Marketingu dhe gjuha e tij
- Fletëpalosje, broshura
- Guida turistike, faqe interneti dhe blogje
- Hyrje në Interpretim
- Interpretimi konsektiv,
- Mbajtja e shënimeve; çfarë të shënojmë
- Interpretimi simultan